REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. 5
Org Jedinica
Org Unit
Nr.i faqeve 2
Br.stranica
No.pages
Nr Prot:
Broj Prot: 1150
Prot.No:
Data:
Datum: 31.08.21
Date:
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Datë: 31.08.2021
Nr. 5 - 1150

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të kërkesës për licencim nga BPrAL- Kolegji "Fama" nr. 1150 të datës: 09.07.2021, nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa e kolegjit "Fama"- Prishtinë. nr. 1150 të datës: 09.07.2021, për licencim.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, shqyrtoi kërkesën me nr. 1150 të dt. 09.07.2021 të parashtruar nga kolegji "Fama" për licencim.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga kolegji "Fama", vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse nuk ka ofruar vendimin e AKA-së për akreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në kërkesën e tij drejtuar Komisionit për licencim të BPrAL-ve.

Ndërsa, sipas nenit 6 paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, MASHTI licencon BPrAL të cilat ofrojnë programet e akredituara.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Arkivit të MASHTI;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSHT;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

**Burim Gashi**